




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS - OPŠTINA PODUJEVO		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA UPRAVA		
Dërguar më Dostavljeno	31 / 12 / 2021	
Njësi.org. Org. jed.	Nr. Br.	
01-020/02-	0111866/21	/



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 41 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040, Udhëzimit Administrativ nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, dhe nenit 35 paragrafët 1 dhe 2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2021 dhe e vazhduar më 30 dhjetor 2021, mori këtë:

VENDIM PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PODUJEVËS

Neni 1

z.Hilmi Hoxha, Profesor i Lëndës së Gjeografisë, nga fshati Obrangj, Komuna e Podujevës, zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Neni 2

Mandati i Kryesuesit të Kuvendit ndërlihet dhe është në kohëzgjatje të njëjtë me mandatin e anëtarëve të Kuvendit.

Neni 3

Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe aktet nënligjore të nivelit qendror dhe ato të Komunës.


Neni 4

Kryesuesi i Kuvendit, për punët dhe angazhimet në kuadër të kompetencave dhe fushëveprimtarisë së Kuvendit, kompensohet konform legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-020/02-0111866/21
Podujevë,
30 dhjetor 2021



Kryesuesi i Kuvendit
Hilmi Hoxha